



| | | | |
|--|---|--------------------|--|
|  Republika e Kosovës Republika Kosovo | Zyra e Personelit Kancelarija za Osoblje | |  Komuna e Istogut Opština Istok |
| | 02 Nr 37/ 23 | Data 03.03.2023 | |

Në mbështetje të nenit nenit 79 dhe 80 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë; nenit 8 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës si dhe neneve: 5, 7 dhe 8 të Rregullores (QRK)Nr.05/2022 për Procedurat Konkruuese dhe Pranimi i Nëpunësit Administrativ dhe Mbështetës, Komuna e Istogut shpall:

K O N K U R S

Institucioni: Komuna e Istogut
Drejtoria: Drejtoria për Mirëqenje Sociale
Titulli i vendit të punës: Kuzhinier/e
Titulli i Mbikëqyrësit: Shefi i Shërbimit
Numri i pozitave : 1 (një)
Niveli i Pagës: Koeficienti 5.5
Orët e Punës: 40 orë në javë
Periudha e Kontratës: Në kohë të pacaktuar
Kohëzgjatje e periudhës provuese: Gjashtë (6) muaj

Përshkrimi i detyrave dhe Përgjegjësi:

1. Përgaditja e ushqimeve: ushqime të ftohta, paragiella, supa, roshtil, sallata dhe ëmbëlsira;
2. Kujdeset për shpenzim të artikujve ushqimor të cilat i merr në përgaditje;
3. Është përgjegjës/e për kualitetin ushqimeve dhe sallatave ;
4. Bënë përpunimin e artikujve ushqimor me urdhërin e shefit të shërbimit;
5. Në mungesë të shefit të shërbimit bëjnë organizimin e shpërndarjes së ushqimeve me kohë për rezident;
6. Kujdeset për përdorimin e mjeteve të kuzhinës në mënyrë të rregullt;
7. Është përgjegjës/e për materialin dhe artikujt ushqimor në të cilat ngarkohet nga shefi i shërbimit si dhe
8. Kryen punë dhe detyra tjera të parashtruara nga mbikëqyrësi.

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:

Të drejtë për konkurim - punësim kanë të gjithë personat e moshës madhore të cilët kanë zotësi për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgaditjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë për kryerjen e detyrave të punës.

Shkathtësit e kërkuara (kualifikimet, përvojat si dhe shkathtësitë e tjera që kërkohen për këtë vend të punës:

- Përgaditja shkollore e mesme - së paku 2 vite përvojë pune;
- Gadishmëri për punë në ekip;
- Shkathtësi të shkëlqyeshme të komunikimit në gjuhën zyrtare;

Dokumentet e kërkuara:

- Dëshmia përkatëse për posedimin e diplomës së shkollës së mesme
- Dëshmi të përvojës së punës
- Dy rekomandime
- Letërnjoftimi
- Ekstrakti nga libri amë i të lindurve

- Dy rekomandime
- Letërnjoftimi
- Ekstrakti nga libri amë i të lindurve
- Çertifikata që nuk jeni nën hetime;

Konkursi mbetet i hapur: 8 ditë, prej datës 17.03.2023 deri 24.03.2023.

Kandidatët e interesuar aplikacionet mund ti marrin në formë fizike, çdo ditë pune, në Qendrën për Shërbime me Qytetar, dhe të plotësuara ti dorëzojnë në Qendrën për Shërbim me Qytetarë, zyra nr.100- kati i parë, në ndërtesën e Komunës.

Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret dhe hynë në listën e ngusht do të ftohen në intervistë.

Mirëpritren aplikacionet prej meshkujve dhe femrave të të gjitha komuniteteve të Republikës së Kosovës

Aplikacionet e dorzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e pakompletuara refuzohen.

Rezultatet shpallen në web faqe e komunës dhe linkun <https://konkursi.rks-gov.net/>

